

Asambleja Europiane SME

20 nëntor 2018,
Graz/Austri

SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Asambleja Europiane vjetore e SME-ve

Editorial

Më datat 19-21 nëntor 2018, u mbajt në Graz të Austrisë Asambleja Europiane vjetore e SME-ve (NVM-ve). Ky aktivitet u organizua nga Komisioni European në bashkëpunim me qeverinë Austriake, e cila mban edhe presidenën e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Komisioneri i BE-së z.Gunther H. Oettinger, tha se: SME-të nuk janë vetëm në qytetet e mëdha, ato janë të gjitha qytetet e rajonet dhe për këtë arsye infrastruktura e shpejtë digjitale 5G në të gjithë BE-në kërkon që qytetarët duhet të marin njohuri për dixhitalen dhe sipërmarrjen si dhe të nxjerrin mësim nga e kaluara.

Në një nga ditët e aktiviteteve të Asamblesë për NVM 2018, një

vëmendje e veçantë iu kushtua edhe Gruas Sipërmarrëse. Në një tryezë të rrumbullakët u mbledhën Gratë Sipërmarrëse nga e gjithë Europa, ku nga Shqipëria merrnin pjesë znj.Flutura Xhabija, presidente e SHGPAZ, si dhe znj.Albana Laknori përfaqësuese e DHTI Tiranë. Gjatë këtij takimi u diskutua për gjetjen e sistemit më

të përshtatshëm për rritjen e sipërmarrjes së grave në vendet e BE-së si dhe në gjithë Europën.

Edhe qeveria shqiptare duhet t'i kushtoj kujdes të veçantë politikave mbështetëse për sipërmarrjen femërore.



Buletin Informativ

Nëntor 2018

NË KËTË NUMËR

Finalistët e projektit IDEA 2018

Më 2 nëntor 2018, u shpallën 5 idetë më të mira të biznesit të përzgjedhura nga reth 400 ide të prezantuara. F2



Forumi Rajonal i Sipërmarrjes Rinore

Më 20-21 nëntor 2018 u mbajt Forumi Rinor i Sipërmarrjes i vendeve të Ballkanit Perëndimor. F.9



Takim me ambasadoren e Indonezisë

nga Flutura Xhabija

100 herë më i madh, dhe vjen nga larg për të gjetur mundësi bashkëpunimi: tregtar dhe kulturor! Në kohrat e tanishme, globalizmi afron skajet, nganjëherë më shumë se komshinjtë, aty afër, ngjitur dhe ndoshta edhe në një "shtëpi"! Bota u bë e vogël tashmë, prandaj, mos humb rastin, hyr në lidhje dhe gjej çfarë ke për të dhënë e merr çfarë të mungon, çfarë të duhet ose e bëjnë më mirë se ti! 🙌!

Kështu më datë 27 nëntor 2018, në një mjedis komod, u ftuam në Tiranë, nga ambasadorja e Indonezisë me stafin e saj profesional dhe disa biznesmene. Me prezantimin e tyre multimedial dhe b2b treguan një interes ndaj biznesit tonë dhe si



herë të parë, informacioni ishte mjaft i plotë! Shpresoj të bashkëpunojmë edhe Ne 🙌 Flm shumë konsulles së nderit prof. Blerina Kapllani 🙌🙌🙌

Finalistët e projektit IDEA 2018




Më 2 nëntor 2018, në ambjentet e Hotel Hilton garden Tiranë, pas një rrugëtimi shtatë mujor, u kurorëzuan 5 idetë më të mira të biznesit të përzgjedhura mes 16 finalistët dhe 400 konkurrentëve që morrën pjesë në trajnimet intensive të Sfida IDEA për zhvillimin e idesë dhe biznesit të tyre. Në këtë takim përshëndetëtën Z/v. ministria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, znj. Albana Shkurta dhe znj. Maren Kneller, përfaqësuese e Ambasadës Gjermane. 5 idetë fituese:

- 🏠 Genta Ahmeti
- 📖 Erika dhe Dritan Meminaj
- 🏠 Nesila Hajdini
- 👤 Jorgo Caca
- 🏠 Rinalda Lika

Bankat dhe biznesi

Shtrëngohen kushtet e kreditimit të bankave për të biznesit në 3/m tretë 2018

Nga Tefta Demeti



Sipas Bankës së Shqipërisë, performanca e kredisë për SME në tremujorin e tretë të vitit 2018 ka qenë e dobët. Portofoli i kredisë së bankave për këtë segment është ulur me 0.5 miliardë lekë krahasuar me tremujorin e dytë, ose 5.7% më pak se një vit më parë. Në këtë turrje ndikimin më të madh e dha kredia për biznesin e mesëm. Rënia e financimit për SME-të ka reflektuar si reduktimin e kërkesës për financim pranë bankave ashtu edhe kushtet e shtrënguara të bankave në këtë tremujor, sikurse konfirmohet nga rezultatet e vërtetimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë. Kërkesa më e pakët nga SME është ndikuar si nga gjendja më e mirë e likuiditetit të tyre në linjë me prurjet sezonale turistike, ashtu edhe nga mungesa e planeve për të bërë investime. Ndikim ka patur dhe rënia e besimit të bizneseve dhe perceptimi i tyre për situatën e përgjithshme makro. Ndërkohë, sipas vërtetimit bankat kanë shtrënguar kushtet e kreditimit për këtë segment, të

cila janë ndikuar nga rreziku i sektorit, perceptimi bankës për rrezikun e kolateralit, toleranca e ulët e bankave për të marrë përsipër rrezik si dhe struktura e

bilancit të bankave.

Gjithashtu, kërkesat rregullative të aplikuara

që në fillim të vitit për dhënien e kredisë bazuar në bilancet fiskale edhe për këtë segment, mendohet se kanë ndikuar si në kërkesën për financim ashtu edhe kushtet e kreditimit për këto biznese.

Gjatë tremujorit të tretë, vihet re se kredia për SME ka reflektuar rënien më të lartë të kredisë në lekë për këtë grup, ndërkohë që kredia në valutë ka shfaqur një rënie më të lehtë. Turrja vjetore kredisë në lekë me 7.8% është reflektuar në rënie të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit në


44.5% përkundrejt 45.3% që shënonte në muajin qershor. Ndërkohë, kredia në valutë u tkurr me norma më të ulët vjetore, me

3.1% dhe pesha që zë ndaj kredisë totale për SME është rritur me 1.1

krahasuar me shtator 2017. Zhvillimet e portofolit të kredisë për SME dëshmojnë që zhvendosja e portofolit të kredisë drejt lekut ka ndalur.

Sipas afatit të maturimit vihet re se tkurrja e kredisë për SME në terma vjetorë është ndikuar si nga rënia e kredisë afatshkurtër (-6.6%) ashtu dhe asaj afatgjatë me (-6.1%), ndërkohë që kredia afatmesme ka shfaqur një normë më të moderuar tkurrje (-3%). Struktura e kredisë sipas afatit të maturimit dominohet nga kredia afatgjatë me rreth 53.2%, por krahasuar me një vit më parë ajo është ulur me 0.2pp. Në krahasim me një vit më parë, në rritje është shfaqur kredia afatmesme, e cila shënoi një peshë prej 18.6% ndaj totalit të kredisë për SME ose 0.5 pp më lart se një vit më parë.

Gjithsesi duhet pranuar që kjo ecuri reflekton edhe mbiçmimin e fortë të lekut ndaj monedhës së përbashkët evropiane. Dhe dominimi i këtij portofoli nga kredia në valutë, kryesisht euro, tejçon një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e portofolit në fund të qershorit.



Konferenca Kombëtare mbi “Sipërmarrjen Sociale dhe Ekonominë e Gjelbër” dhe sfidat e zbatimit në Shqipëri”

Nga Tefta Demeti

Më 1 nëntor 2018, UN Women në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizuan konferencën kombëtare mbi “Sipërmarrjen Sociale dhe Ekonominë e Gjelbër në Shqipëri”. Konferenca njëditore synonte hapjen e derës për shoqërinë civile, të rinjtë, grupet në disavantazh, si dhe gratë dhe vajzat shqiptare për t’u angazhuar më shumë në iniciativat dhe programet e sipërmarrjes sociale. Konferenca paraqiti disa nga praktikat më të mira dhe më të suksesshme të sipërmarrjes sociale

evropiane dhe të ekonomisë së gjelbër. Pjesëmarrësit mësuan përmes shembujve konkretë se si ndërmarrjet sociale kishin ndikuar pozitivisht në grupet e marginalizuara në vende si Greqia, Rumania, Italia dhe Spanja. Znj. Merita Xhafaj, Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tha në fjalën e saj të hapjes



se Qeveria Shqiptare synon të mbështesë ndërmarrjet sociale në vend, me synim të punësimit dhe mundësive të tjera për grupet vulnerabël.

Por a do të sjellë rritjen e punësimit ky ligj i ri për ndërmarrjet sociale?? Një debat pati në këtë konferencë me kendvështrimin e sjellë nga përfaqësuesja e Partners Albania znj. Juli Hoxha e cila ka qenë e përfshirë në këtë politikë që nga fillimet e saj në vitin 2011.

Disa konflikte vihen re në ligjin e ndërmarrjeve sociale që nga përkufizimi i saj, forma e organizimit, parimet e funksionimit e kriteret ekonomike. Pra OJF vs. Ndërmarrje Sociale!!!

Le të presim zbatimin e ligjit se si do të funksionojë!

Fushata kundër diskriminimit të të moshuarve

1 Tetor-10 dhjetor 2018



Periudha 1 tetor - 10 dhjetor 2018 është shpallur si periudha 70 ditore e fushatës globale kundër diskriminimit moshor dhe në këtë kuadër Shoqëria Shqiptare për të Gjitha Moshat, ASAG, me presidente Mira Pirdeni po organizojnë një sërë aktiviteteve sensibilizuese për një vemëndje ndaj kësaj shtrese të popullatës si dhe për një moshim aktiv. SHGPAZ mbështet ASAG në këtë misionin historik dhe jep shembullin e saj frymëzues se gratë në moshë po vazhdojnë të kontribojnë pranë kësaj organizate, NGO, në zhvillimin e sipërmarrjes femërore në Shqipëri.

Mbresa nga Graz/Austri në ditët e organizimit të Asamblesë Europiane të SME-ve

Nga Flutura Xhabija

Data 21 nëntor 2018. Kam dy ditë që ndodhem në Graz, qyteti i dytë austriak, pas Vjenës: për nga tradita dhe industria, edukimi dhe inovacionin. Ky qytet mbrohet nga UNESCO, për arkitekturën speciale dhe antike; si dhe njihet për industrinë e birrës, industrinë automotive, arsimimin (ka 8 universitete me 160,000 studentë nga e gjithë bota, ndërmjet tyre edhe dhjetra shqiptarë smart) etj. Por ky habitat civilizues, është edhe qyteti i mjaft personaliteteve shqiptare që studiovan, punuan dhe shkëlqyen si: Aleksandër Moisiu, Aleks Buda, Marie Kraja, albanologë të shquar si Gustav Mayer. Këtu ndodhen 13 letrat e Ndre Mjedës, korrespondencë gjëniale për shqipen dhe rrënjët e saj, bukurinë dhe pasurinë e saj, etj, etj.



Prandaj mora këtë rrugë, edhe pse me pak probleme shëndetësore, për kontributin e



para-ardhësve të mij të shquar dhe për pjesëmarrjen time në Asamblenë Vjetore të Bisnesit të Vogël dhe të Mesëm, organizuar nga Bashkimi European. Një aktivitet i organizuar me mjaft cilësi dhe mundësi për të përfituar përvojë, bashkëpunim dhe network.

Nuk e kam pasur e nuk e kam të lehtë, totalisht e kryesisht nga politika shqiptare, por besoj që puna e nderhme dhe përkushtimi nuk humb kurrë! Së fundmi, u kënaqa me borën e parë të Graz-it, me fizarmonikën austriake dhe me ushqimin ekstremisht bio... per momentin kaq! Faleminderit

Dita ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve

20 nëntor 2018. Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, u organizua Aktiviteti "Dëgjo Zërin tim", i cili synonte sensibilizimin e opinionit publik mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave të fëmijëve, me fokus të veçantë fëmijët në nevojë, mobilizimin e fëmijëve për të ngritur zërin dhe



për të adresuar çështjet në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre si dhe promovimin e pjesëmarrjes kuptimplotë të fëmijëve në shkollë dhe komunitet.

Këto aktivitete u organizuan dhe u mbështetën nga Save the Children in Albania, European Union in Albania, UNICEF Albania, Terre des hommes Albania, World Vision in Albania and Kosovo



Të thënat dhe të pathënat e buxhetit dhe paketës fiskale 2019

Biznesi: Ka kosto “të fshehta” për qytetarët dhe bizneset

nga **Violeta Shqali**

Përfaqësues të shoqatave të ndryshme në vend kanë ngritur shqetësimin se disa taksa në mënyrë indirekte do të kalojnë tek blerësi fundor, pra qytetari siç është ajo e taksave që i janë ngarkuar vit pas viti sektorit të ndërtimit. Biznesi ka argumentuar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, se nga ana e qeverisë nuk janë marrë parasysh propozimet e tij për paketën fiskale 2019 ndërkohë që ka bërë pak komente për buxhetin e vitit të ardhshëm.

-Luigj Aleksi përfaqësues i Shoqatës së Ndërtuesve tha se sektori ndërtimit vuan disa shqetësime lidhur me ndryshimet ligjore që nuk janë përmirësime që ndikojnë në rritjen e fitimit por që i ngarkohen blerësit.etj.

“Taksa e infrastrukturës që i paguhet bashkisë ka qene 5% mbi kosto, shtohet 100 euro për metër katror. Nga kjo taksë nuk zbriten punimet që bëhen. Ndërtuesi bën infrastrukturën me lekët e veta. Fuqia punëtore për ndërtimin e një pallati është e barabarte që për një vit mos të punojnë 200 punonjës. Problemi i dytë është 3% i strehimit social që është minimumi 20% e fitimit. Ndërtuesit i bëhet diskriminim sepse ngarkohet me këtë taksë ndërkohë që nuk jemi kundër ndikimit dhe kemi pranuar më mirë të rritet si taksë. Problemi i tretë është taksa e dheut, dheu në Shqipëri konsiderohet inerte e rrezikshme. Dherat vetëm nga

zonat e kontaminuar quhet mbetje e rrezikshme këtu tek ne nuk merret parasysh. Taksa e pronës, banesat stok do taksohen me taksën e pronës ndërkohë që ai është mall e kemi ngritur ne Ministrinë e Financave duhet riparë me kujdes.

Për ne ndërtuesit problemi kryesor është prokurimi publik duhet të rregullohet sa me parë. Për shembull një rast konkret tek rikonstruksioni i shkollës “Dritero Agolli” kërkohet 11 inxhinierë dhe mes tyre dhe një inxhinier pyjesh, pagesa është më e madhe sesa vlera e ish-objektit” tha Aleksi.

-Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë ka disa pika që duhet të shihen me kujdes ndërkohë që iniciativat ligjore që mbarin kosto për biznesin duhet të kalojnë në debat më të gjerë.

“Persa i përket rimbursimit të TVSH, akcizës do sjell një problematike që na shqetëson. Vlerësojmë nismën e qeverisë për taksimin e sipërmarrjes por vëmë re që kanë lindur një sërë nismash ligjore që edhe pse nuk shprehen përfaqësojnë një taksë të fshehur. Bëhet fjalë për ligje pa konsultim publik siç ishte ajo mbi sigurinë publike. E konsiderojmë një taksë ku përfshijnë të gjitha bizneset që kanë xhiro mbi 10 mln lekë.

Përveçse sipërmarrësi nuk është i ndërgjegjshëm nuk ka vetedije sesa telekamera vendos në atë vend, me ironi do të thosha është një ligj që bëhet për ata që shesin telekamera. Ne kemi bërë sondazh dhe asnjë shtet nuk na rezulton të ketë një ligj të tillë. Të rishikohet ky ligj pasi ka



kosto për biznesin. Në Itali po diskutohet ligji “Për mbrojtjen civile” ne u vumë në dijeni nga shtypi në këtë rast vete biznesi ka një kosto shtesë se çfarë duhet të bëjë në rast të një fatkeqësie natyrore” thanë përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.

- Përfaqësuesi i Dhomës Amerikane të Tregtisë Mark Crawford tha se duhet të shihen me kujdes taksat për çështjet e gjyqësorit, ajo e zhavorrit si dhe taksa e kalimit të kapitalit jashtë.

-Presidenti i Bisnes Albania, Luan Bregasi, nga ana tjetër u shpreh se biznesi përballet me kosto të larta të ujit dhe energjisë në kushtet kur humbjet në rrjetet e secilës mbeten të larta. *“Jemi vendi i vetëm në rajon që biznesi ka çmimin e energjisë dyfish por nëse humbjet në rrjet janë ulur të na ulin dhe ne taksën. Të gjitha propozimet ne i kemi bërë për shembull akcizë për qelqin nuk ka asnjë vend në botë apo për pullat për solarin që jemi të ngarkuar nga pikëpamja fiskale. Të shihet seriozisht mungesa e konkurrueshmërisë sepse jemi në konkurrencë me vendet e rajonit”* tha Bregasi.

-Agim Rrapaj nga Këshilli i Agrobiznesit tha se është ulur ndjeshëm buxheti për sigurinë ushqimore. Lidhur me mbetjet e kafshëve ai ngriti si shqetësim që nuk ka fonde dhe janë 1 milionë tonë mbetje dhe në këtë kontekst Rrapaj propozoi që të shtohet një zë në buxhet për mbetjet organike.

FAKTE

29.7%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2017 në Shqipëri rezultojnë 29.7% me një ritje prej 2.9 pikë % krahasuar me 2016, por me një rënie me 1.6 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë)



Aktivitet me rastin e 550 vjetorit i vdekjes së Skënderbeut, në Vatikan

19 Nëntor 2018. Me rastin e 550 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, në ceremoninë e organizuar në Vatikan, përpara disa dhjetëra pelegrinëve shqiptarë dhe arbëresh, Papa Françesku në fjalën e tij, i thurri lavde kulturës, traditave dhe harmonisë së shkëlqyer midis komuniteteve fetare në Shqipëri.

Mesazhi i bashkimit dhe vëllazërimit dhe i mirësisë duhet të sundojë edhe sot në realitetin



shqiptar për të mirën e popullit

shqiptar dhe Shqipërisë.

Shkolla e Modës në Shkodër

Më 2 nëntor 2018, u hap në Shkodër Dega e Shkollës së Modës Italiane, ku merrnin pjesë edhe anëtarët e SHGPAZ dega Shkodër.

I Urojmë suksese në rrugën e edukimit të brezave të rinj me ide të reja e kreative në fushën e modës!



Gruaja dhe shëndeti

Sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (SPOK)

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Sëmundjet pulmonare obstruktive kronike (SPOK) janë një tip i sëmundjeve obstruktive (bllokuese) të mushkërive të karakterizuara nga probleme afatgjata të frymëmarrjes dhe kalim i reduktuar i ajrit. Në këtë grup bëjnë pjesë sëmundje të tilla si astma, bronkiti kronik, emfizema. Simptomat kryesore përfshijnë gulçimi dhe kollë me prodhim pështyme. SPOK janë sëmundje progresive, që do të thotë se zakonisht përkeqësohen me kalimin e kohës.

Përfundimisht aktivitetet e përditshme, të tilla si ecja ose veshja, bëhen të vështira. SPOK janë një nga sëmundjet më të përhapura në botë është aktualisht shkaku kryesor i vdekjeve në botë. Janë shumë të përhapura në vendet me të ardhura të ulëta dhe numri i individëve që vuajnë nga këto sëmundje në botë kap shifrën 250 milionë.

Simptomat që shfaqen më shpesh janë:

- Mosmbushja me frymë
- Shtrëngimi në krahator
- Kolla me mukus (gëlbasë) të tepërt, sidomos në mëngjes
- Fishkëllima në frymëmarrje

Shkaktarët kryesorë të SPOK-ut

Pirja e duhanit e është shkaku më i zakonshëm, ndësa faktorë të

tillë si ndotja e ajrit, pluhurat dhe kimikatet në vendin e punës apo gjenetika luajnë një rol më të vogël. Në vendet në zhvillim, ndër burimet më të zakonshme të ndotjes së ajrit janë sistemet e ngrohjes të paventiluara dhe zjarret e gatimit. Ekspozimi afatgjatë ndaj këtyre irrituesve shkakton një reagim inflamator në mushkëri, duke rezultuar në ngushtimin e rrugëve të frymëmarrjes dhe prishjen e indeve të mushkërisë.



Si diagnostikohet SPOK-u?

Doktori juaj duhet t'ju pyesë për historinë mjekësore dhe duhet t'ju bëjë një ekzaminim fizik.

Ai mund të kërkojë një ose disa nga testet e mëposhtme:

- Grafi të thjeshtë me rreze-x dhe/ose skaner të toraksit.
- Teste të funksioneve pulmonare (të mushkërive) – një teknik i sëmundjeve të mushkërive përdor disa teste për të parë sa

mirë funksionojnë mushkëritë tuaja.

- Oksimetri e pulsit – një test pa dhimbje që mat nivelin e oksigjenit në gjak.
- Analizë e gazit në gjak – një test gjaku që mat sasinë e oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në gjak.

Mënyrat e trajtimit të SPOK-ut

Shumica e rasteve të SPOK mund të parandalohen duke reduktuar ekspozimin ndaj faktorëve të

rrezikut. Kjo përfshin uljen e nivelit të duhanpirjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm dhe të jashtëm. Ndërsa për mënyrat e trajtimit mund të përmendim vaksinimet, rehabilitimin respirator dhe shpesh bronkodilatatorët apo steroidët me thithje (pompat). Në disa raste mund të jetë e nevojshme terapia afatgjatë me

oksigen ose transplantimi i mushkërive. SPOK-u nuk është i kurueshëm, por trajtimi mund të lehtësojë simptomat, përmirësojë cilësinë e jetës dhe të zvogëlojë rrezikun e vdekjes.

Forumi Rajonal i Sipërmarrjes Rinore

nga Arlinda Demeti



Në datat 20 -21 Nëntor 2018 u zhvillua në Durrës "Forumi Rajonal për Sipërmarrjen Rinore" organizuar nga OJQ-ja "Përtej Barrierave" dhe partnerët e saj rajonal. Ky ishte forumi i dytë rajonal pjesë e projektit WEB4YES - Organizatat e Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për Mbështetjen e Punësimit të të Rinjve që solli bashkë në Shqipëri përfaqësues të Ministrive, Bashkive, Sindikatave, OJQ-ve nga Ballkani Perëndimor dhe nga Shqipëria të cilët punojnë dhe influencojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave të punësimit dhe sipërmarrjes së të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu në hapjen e eventit u prezantua dhe Platforma dixhitale për punësimin e të rinjve në rajon –

WEB4JOBS, si një risi në llojin e saj dhe e para platformë rajonale e Ballkanit Perëndimor. Më tej u paraqitën Raportet Rajonale "Zhvillimi dhe promovimi i edukimit sipërmarrës gjatë gjithë jetës dhe Mjedisi mundësues për sipërmarrjen rinore", që janë produkt i dialogut konstruktiv midis gjithë aktorëve të rëndësishëm të fushës.



Projektet e BE-së ndërkufitare Shqipëri-Mali I Zi



Podgorice: 9 nëntor 2018 !

Edhe pse ngadalë, bashkëpunimet ndërkufitare mbeten objektiv i BE-së dhe më mirë se shoqëria civile, asnjë institucion tjetër nuk mund ta bëjë. Sprovat filluan nga 2016-ta dhe me përvojat e deritanishme, diçka krijohet: njohja e aktorëve reale të njeri-tjetrit, informim i nevojave të përbashkëta dhe këmbimi i përvojave...pastaj bashkëpunimi real.


Katër anëtare të SHGPAZ morrën pjesë në hapjen e thirrjeve për projekte ndërkufitare Shqipëri-Mali i Zi; SHGPAZ ka treguar se në këtë rrugë të vështirë, me shuma eurosh shumë të vogla, ka implementuar projekte me produkte reale dhe veprimtari efektive. Le të shpresojmë në aplikime të suksesshme në të ardhmen! 🙌🙌🙌

Industria kreative dhe aftësitë profesionale

AlbanianSkills dhe SHGPAZ organizuan debatin e tretë – “Crafts are so vital to our culture, economy and society”, - me fokus punimet e dorës tek punishtja e Valbona Sina në Durrës.

Valbona është anëtare e Shoqatës së Grave Profesioniste Afariste e Zejtare të Shqiperise dhe gjatë këtij takimi në punishten e qëndaristisë u

diskutua rreth zanateve të dorës, zejeve, si dhe u shkëmbye eksperiencia rreth çështjeve, se çfarë e ka bërë të suksesshme në treg Valbonën, dhe të gjithë duarartët si ajo, çfarë aftësish kërkohen dhe sa sistemi ynë arsimor por edhe ekonomia e shoqëria në tërësi i ofrojnë këto aftësi dhe mundësi.



Takim me degën e SHGPAZ Shkodër



Më date 8 nëntor 2018 presidentja e SHGPAZ, znj.Flutura Xhabija morri pjesë në takimin e organizuar nga anëtarët e SHGPAZ dega Shkodër ku u diskutua rreth arritjeve të degës gjatë vitit 2018.

Buletin Informativ

Nëntor 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Përgatiti

Msc. Flutura XHABIJA &
MBA.Tefta DEMETI